

LIGJI Nr. 03/L-157

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR DUHANIN Nr. 02/L-36

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1), Kreu IV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke pasur parasysh kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-36 për Duhanimin me qëllim të krijimit të kushteve që ligji të gjejë zbatueshmëri të plotë,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR DUHANIN Nr. 02/L-36

Neni 1

Neni 3 i Ligjit, paragrafi 3.2 riformulohet si vijon:

3.2 .Prodhimi dhe qarkullimi i cigareve me përmbajtje nga paragrafi 1 i nenit 3 është i obliguar të zbatohet nga 1 janari 2010.

Neni 2

Neni 4 i Ligjit paragrafi 4.1 fjalia “**Qeveria e Kosovës apo Institucioni i autorizuar nga ajo...**” fshihet dhe zëvendësohet me fjalinë “**Ministria e Shëndetësisë...**”

Neni 4 i Ligjit, paragrafi 4.4 fjalia “**Qeveria e Kosovës...**” fshihet dhe zëvendësohet me fjalinë „**Ministria e Shëndetësisë...**”

Neni 4 i Ligjit, paragrafi 4.5 , riformulohet si vijon:

4.5. Testimet për substancat e përfshira në pikën 3 të nenit 4 duhet të bëhen me standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë përmes zbatimit të standardeve ISO. Duhet të përdoren këto standarde, ISO standardi 4387 për katranin, 10315 për nikotinën dhe 8454 për monoksidin e karbonit. Saktësia e paraqitjes të sasisë së katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit në paketim verifikohet përmes ISO standardit 8243. Ministria e Shëndetësisë siguron ISO standardet 6 muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi.

Neni 4 i Ligjit paragrafi 4.8 riformulohet si vijon:

4.8. Në qoftë se përbërja e mostrës së marrë nga një seri e prodhimeve të duhanit, dëshmohet nga laboratorit i licencuar se nuk i përmbahet vlerave të parapara me ligj atëherë ajo seri tërhiqet nga tregu.

Neni 4 i Ligjit, paragrafi 4.9 fjalia “**Institucion i autorizuar nga Qeveria e Kosovës...**” fshihet dhe zëvendësohet me fjalinë “**Ministria e Shëndetësisë...**”

Neni 3

Neni 6 i Ligjit, paragrafi 6.2, nën-paragrafi a) pika II riformulohet si në vijim:

II. Pirja e duhanit dëmton seriozisht shëndetin tuaj dhe rrethit tuaj.

Neni 6 i Ligjit, paragrafi 6.2, nën-paragrafi a) pika I. dhe III. riformulohen si në vijim:

I. Duhani dëmton shëndetin tuaj.

III. Pirja e duhanit nga shtatzënat e dëmton zhvillimin e fëmijës.

Neni 6 paragrafi 6.4 riformulohet si vijon:

6.4. Vërejtja e përgjithshme shtypet në faqen ballore, kryesore të njësisë së paketimit të prodhimeve të duhanit dhe duhet të përfshijë 30% të kësaj sipërfaqeje të dukshme përveç mbështjellësve të tejdukshëm.

Neni 6 paragrafi 6.5 riformulohet si vijon:

6.5. Vërejtja shtesë shtypet në sipërfaqen tjetër më të dukshme, e pasme të njësisë së paketimit të prodhimeve të duhanit dhe duhet të përfshijë dyzet (40) % të kësaj sipërfaqeje përveç mbështjellësve të tejdukshëm.

Neni 6 i Ligjit, paragrafi 6.6 fshihet dhe paragrafët në vijim radhiten sipas radhës.

Neni 4

Neni 7 i Ligjit paragrafi 7.1 në rreshtin e dytë fjalia “...organeve përgjegjëse...” zëvendësohet me fjalinë “...Ministrisë së Shëndetësisë...”.

Neni 7 i Ligjit paragrafin 7.6 fjalia “Organet kompetente...” zëvendësohet me fjalinë “Ministria e Shëndetësisë...”.

Neni 5

Neni 10 i Ligjit, pas paragrafit 10.3 shtohet paragraf i ri 10.4 me përmbajtjen si vijon:

10.4. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha mjetet e transportit publik.

Neni 6

Neni 11 i Ligjit paragrafi 11.3, në fund të këtij paragrafi shtohet fjalia “Kryesues i këshillit profesional për kontrollin e duhanit është Ministri i Shëndetësisë”.

Neni 7

Neni 14 i Ligjit ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

14.1. Prodhuesit dhe importuesit e prodhimeve të duhanit janë të obliguar që në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji të vendosin shenjëzimet në paketimet e prodhimeve të duhanit të përcaktuar me këtë ligj.

14.2 Institucionet, organizatat e të gjitha llojeve si dhe mjetet e transportit publik, janë të obliguara që në afat prej katër (4) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të vendosin shenjat e ndalesës së pirjes së duhanit dhe të përcaktojnë vendet ku mund të pihet duhani në qoftë se përcaktohen këto vende, sipas ligjit.

Neni 8

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-157
11 shkurt 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-007-2010, datë 02.03.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.